



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.16**

**Datë 6 mars 2006**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9468 datë 2.2.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për mbetjet eksplozive të luftës”, të Konventës “Për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të armëve të quajtura konvencionale, të cilat mund të konsiderohen se shkaktojnë dëmtime të mëdha ose pasoja pa dallim” (Protokolli V).....	509
Udhëzim i MBUMK nr.1, datë 20.2.2006	Për ndryshimin e kategorisë së tokës bujqësore dhe kategorizimit të resurseve.....	516
Udhëzim i MASH nr.4, datë 28.2.2006	Për përcaktimin e tarifave të vlerësimit dhe akreditimit për shkollat e larta jopublike.....	518
Vendim i ERE nr.4, datë 25.1.2006	Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë së ERE-s dhe gjendjen e sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri për vitin 2005.....	518
Vendim i ERE nr.5, datë 16.2.2006	Për një shtesë në vendimin nr.1, datë 11.1.2006, për transferimin e licencës nga shoqëria “Korsel” sh.p.k. te shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k.....	532
Vendim i ERE nr.6, datë 16.2.2006	Për një ndryshim në vendimin e këshillit drejtues të ERE-s nr.14, datë 11.7.2003 “Lidhur me kërkesën e bërë nga “Emikel” sh.p.k. për marrje licence për prodhimin e energjisë elektrike”.....	532

Vendim i ERE nr.7, datë 16.2.2006	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....	533
Vendim i ERE nr.8, datë 16.2.2006	Për transferimin e asetëve nëpërmjet shitjes për hidrocentralet e shoqërisë “Sarmier” sh.p.k.....	533
Vendim i ERE nr.9, datë 17.2.2006	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, nga shoqëria “Wonder Power” sh.a. për periudhën 1.1.2006 - 31.12.2006.....	534
Vendim i ERE nr.11, datë 23.2. 2006	Për dhënien e licencave për aktivitetin e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit, importit dhe eksportit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.....	534
Vendim i ERE nr.12, datë 23.2.2006	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....	536
Vendim i ERE nr.13, datë 28.2.2006	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, nga shoqëria “Spahiu-Gjanç” sh.p.k. për periudhën 1.01.2006-31.12.2006.....	536

**L I G J**  
**Nr. 9468, datë 2.2.2006**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN “PËR MBETJET  
EKSPLOZIVE TË LUFTËS” TË KONVENTËS “PËR NDALIMIN OSE KUFIZIMIN E  
PËRDORIMIT TË ARMËVE TË QUAJTURA KONVENCIONALE, TË CILAT MUND TË  
KONSIDEROHEN SE SHKAKTOJNË DËMTIME TË MËDHA OSE PASOJA PA DALLIM”  
(PROTOKOLLI V)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin “Për mbetjet eksplozive të luftës” të Konventës “Për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të armëve të quajtura konvencionale, të cilat mund të konsiderohen se shkaktojnë dëmtime të mëdha ose pasoja pa dallim” (Protokolli V).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4787, datë 24.2.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu**

**PROTOKOLL**  
**MBI MBETJET EKSPLOZIVE TË LUFTËS**  
**(PROTOKOLLI V)**

Palët Kontraktuese,

*duke njohur* problemet e rënda humanitare, postkonfliktuale të shkaktuara nga eksplozivat e mbetur nga lufta,

*të ndërjegjshëm* për nevojën e përfundimit të një protokolli për masat rregulluese pas konflikteve të një natyre të përgjithshme, me qëllim zvogëlimin e rreziqeve dhe ndikimeve të mbetura nga lufta,

*dhe duke dëshiruar* t’i adresojnë masat e përgjithshme parandaluese, përmes praktikave më të mira vullnetare të detajuara në aneksin teknik për të siguruar rehabilitimin e municioneve dhe për të minimizuar ngjarjet me eksploziva të mbetur nga lufta,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

**Dispozita të përgjithshme dhe qëllimi i zbatimit**

1. Në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe rregullave të ligjit ndërkombëtar mbi konfliktet e armatosura të zbatueshme për to, Shtetet Palë Kontraktuese bien dakord në detyrimet e përcaktuara në këtë protokoll, individualisht dhe në bashkëpunim me Shtetet e tjera Palë Kontraktuese, për të minimizuar rreziqet dhe ndikimet e eksplozivave të mbetur nga lufta në situatat postkonfliktuale.

2. Ky protokoll do të zbatohet për eksplozivat e mbetur nga lufta në hapësirën tokësore, përfshirë edhe ujërat territoriale të Shteteve Palë Kontraktuese.

3. Ky protokoll do të zbatohet në situatat që rrjedhin nga konfliktet sipas nenit 1 paragrafi 1 deri 6 të Konventës, shtuar më 21 dhjetor 2001.

4. Nenet 3, 4, 5 dhe 8 të këtij protokollit zbatohen për eksplozivat e mbetur nga lufta, si dhe për eksplozivat ekzistues të mbetur nga lufta, siç përcaktohet në nenin 2 paragrafi 5 i këtij Protokollit.

## Neni 2

### **Përkufizime**

Për qëllimet e këtij protokollit:

1. “Artileri eksplozive” nënkupton municion konvencional që përmban eksploziv, me përjashtim të minave, minave (booby traps) dhe të tjera siç përcaktohet në protokollin 2 të kësaj Konvente e shtuar më 3 maj 1996.

2. “Artileri e pashpërthyer” nënkupton artilerinë eksplozive që është mbushur me barut, armatosur ose e përgatitur ndryshe për t’u përdorur dhe e përdorur në një konflikt të armatosur. Ajo mund të ndizej, hidhej, lëshuar ose projektuar dhe duhet të shpërthente, por ka dështuar dhe nuk është shpërthyer.

3. “Artileri e abandonuar eksplozive” nënkupton artilerinë eksplozive që nuk është përdorur gjatë një konflikti të armatosur, që është lënë ose hedhur nga një palë në një konflikt të armatosur dhe që nuk është më nën kontrollin e palës që e ka lënë ose hedhur atë. Këto eksploziva mund ose jo të kenë qenë mbushur me barut, armatosur ose të përgatitur ndryshe për t’u përdorur.

4. “Eksploziva të mbetur nga lufta” nënkupton artileri të pashpërthyer dhe artilerinë e abandonuar eksplozive.

5. “Eksploziva ekzistues të mbetur nga lufta” nënkupton artileri të pashpërthyer dhe artilerinë e abandonuar eksplozive që ka ekzistuar përpara hyrjes në fuqi të këtij protokollit për Shtetet Palë Kontraktuese në territorin e të cilave ato ekzistojnë.

## Neni 3

### **Kleranca, heqja ose shkatërrimi i eksplozivave të mbetur nga lufta**

1. Secili Shtet Palë Kontraktues dhe palë në një konflikt të armatosur do të marrë përsipër përgjegjësitë e vendosura në këtë nen përsa i përket gjithë eksplozivave të mbetur nga lufta në territorin që gjendet nën kontrollin e tij. Në rastet kur një përdorues i artilerisë eksplozive, e cila është kthyer në eksploziv të mbetur nga lufta, nuk ushtron kontrollin e territorit, përdoruesi, pas pushimit të luftimeve, do të sigurojë, kur është e mundur, *inter alia*, ndihmë teknike, financiare, materiale ose me burime njerëzore, në rang dypalësh ose edhe me një palë të tretë nëse bihet dakord, duke përfshirë *inter alia* sistemin e Kombeve të Bashkuara ose të organizatave të tjera, për të lehtësuar shënjimin dhe klerancën, heqjen ose shkatërrimin e këtyre mbetjeve eksplozive të luftës.

2. Pas pushimit të veprimeve luftarake dhe sa më shpejt të jetë e mundur, secili Shtet Palë Kontraktues dhe palë në një konflikt të armatosur do të shënjojë dhe qartësojë, heqë ose shkatërrojë mbetjet eksplozive të luftës në territoret që ndodhen nën kontrollin e tij. Zonave që ndikohen nga eksplozivat e mbetur nga lufta, që përfitohen sipas paragrafit 3 të këtij neni, duke pasur parasysh që paraqesin një rrezik të rëndë humanitar, do t’i jepet prioritet për klerancën, heqjen ose shkatërrimin.

3. Pas pushimit të veprimeve luftarake dhe sa më shpejt të jetë e mundur, secili Shtet Palë Kontraktues dhe palë në konflikt të armatosur do të marrë masat e mëposhtme, në territoret që mund të preken që janë nën kontrollin e saj, për të zvogëluar rreziqet nga eksplozivat e mbetur nga lufta.

a) Të kontrollojë dhe vlerësojë kërcënimin nga eksplozivat e mbetur nga lufta.

b) Të vlerësojë dhe t’u japë prioritet nevojave dhe praktikës për afatet e shënjimit dhe klerancës, heqjes ose shkatërrimit.

- c) Të shënjojë dhe qartësojë, heqë ose shkatërrojë eksplozivat e mbetur nga lufta.
  - d) Të marrë masat për të mobilizuar burimet për kryerjen e këtyre veprimtarive.
4. Gjatë kryerjes së këtyre verimtarive, Shtetet Palë e Kontraktuese dhe palët në një konflikt të armatosur do të marrin parasysh standardet ndërkombëtare, duke përfshirë standardet ndërkombëtare të aksioneve antiminë.
5. Shtetet Palë Kontraktuese do të bashkëpunojnë, nëse është e mundur, me njëri-tjetrin dhe me shtete të tjera, organizata rajonale dhe ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare për parashikimin e dispozitave të ndihmës, *inter alia*, teknike, finaciare, materiale dhe burime njerëzore duke përfshirë, në rrethana të caktuara, ndërmarrjen e operacioneve të përbashkëta të nevojshme për përmbushjen e dispozitave të këtij neni.

#### Neni 4

### **Regjistrimi, ruajtja dhe transferimi i informacionit**

1. Shtetet Palë Kontraktuese dhe palët në një konflikt të armatosur, sa më shumë të jetë e mundur dhe në mënyrë sa më praktike, do të regjistrojnë dhe ruajnë informacionin për përdorimin e artillerisë eksplozive, për të lehtësuar shënjimin dhe klerancën, heqjen ose shkatërrimin e eksplozivave të mbetur nga lufta, synojë edukimin dhe parashikimin e informacionit përkatës palës që kontrollon territorin dhe popullsinë civile në atë territor.
2. Shtetet Palë Kontraktuese dhe palët në një konflikt të armatosur që kanë përdorur ose lënë artileri eksplozive që mund të jenë bërë eksploziva të mbetur nga lufta, menjëherë pas përfundimit të veprimeve luftarake dhe në mënyrë sa më praktike, subjekt i interesave të ligjshme të sigurisë së këtyre palëve, do t'ua japin këtë informacion palës ose palëve që kontrollojnë atë zonë, në rang bilateral ose përmes një pale të tretë të pranuar, duke përfshirë *inter alia*, Kombet e Bashkuara ose me kërkesë, organizata të tjera, për të cilat pala që siguron informacionin është e bindur se kanë ndërmarrë ose do të ndërmarrin edukimin dhe shënjimin, dhe klerancën, heqjen ose shkatërrimin e eksplozivave të mbetur nga lufta në zonë.
3. Gjatë regjistrimit, ruajtjes dhe transferimit të këtij informacioni, Shtetet Palë Kontraktuese duhet të mbajnë parasysh pjesën e 1-rë të aneksit teknik.

#### Neni 5

### **Masa të tjera për mbrojtjen e popullsisë civile, individët civilë dhe objektet civile nga rreziqet dhe ndikimet e eksplozivave të mbetur**

Shtetet Palë Kontraktuese dhe palët në një konflikt të armatosur do të marrin të gjitha masat e mundshme në territorin që ndodhet në kontrollin e tyre, të ndikuar nga eksplozivat e mbetur nga lufta, për të mbrojtur popullsinë civile, individët civilë dhe objektet civile nga rreziqet dhe ndikimet e eksplozivave të mbetur nga lufta. Masat e mundshme janë masat që janë praktike ose të zbatueshme në praktikë, duke mbajtur parasysh gjithë rrethanat e kohës, duke përfshirë kërkesat humanitare dhe ushtarake. Këto masa mund të përfshijnë paralajmërime, edukimin në rast rreziku të popullsisë civile, shënjimin dhe kontrollimin e territorit që ndikohet nga eksplozivat e mbetur nga lufta, siç përcaktohet në pjesën 2 të aneksit teknik.

#### Neni 6

### **Dispozita për mbrojtjen e misioneve humanitare dhe organizatave nga ndikimet e eksplozivave të mbetur nga lufta**

1. Secili Shtet Palë Kontraktues dhe palë në një konflikt të armatosur:
- a) do të mbrojë për aq sa është e mundur, nga ndikimet e eksplozivave të mbetur nga lufta, misionet humanitare dhe organizatat që janë duke vepruar ose do të veprojnë në zonën që ndodhet nën kontrollin e Shteteve Palë Kontraktuese ose të një pale në një konflikt të armatosur dhe me pëlqimin e asaj pale.

b) pas kërkesës nga një mision humanitar ose organizatë, do të sigurojë, sa më shumë të jetë e mundur, informacion për vendndodhjen e të gjithë eksplozivave të mbetur nga lufta ose për çfarë ka dijeni për territorin ku do të veprojë, ose është duke vepruar misioni humanitar ose organizata.

2. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë ligjin ndërkombëtar humanitar ose instrumente të tjera ndërkombëtare të zbatueshme, ose vendime të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që sigurojnë nivel të lartë mbrojtjeje.

#### Neni 7

### **Ndihma përsa i përket eksplozivave ekzistues të mbetur nga lufta**

1. Secili Shtet Palë Kontraktues ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë ndihmë, nëse është e mundur, nga shtete të tjera Palë Kontraktuese, nga shtetet që nuk janë palë dhe organizata, dhe institute ndërkombëtare përsa i përket problemeve që lidhen me eksplozivat ekzistues të mbetjeve nga lufta.

2. Secili Shtet Palë Kontraktues do të sigurojë ndihmë në lidhje me problemet e eksplozivave ekzistues të mbetjeve nga lufta, përsa është e nevojshme dhe e mundur. Gjatë kësaj, Shtetet Palë Kontraktuese do të marrin parasysh objektivat humanitarë të këtij protokollit, si dhe standardet ndërkombëtare përfshirë standardet ndërkombëtare të aksionit antiminë.

#### Neni 8

### **Bashkëpunimi dhe ndihma**

1. Secili Shtet Palë Kontraktues, në gjendje ta bëjë këtë, do të sigurojë ndihmë për shënjimin dhe klerancën, heqjen ose shkatërrimin e eksplozivave të mbetur nga lufta dhe për edukimin e popullsisë civile rreth rrezikut dhe veprimtari të tjera të lidhur me to, *inter alia*, nëpërmjet sistemit të Kombeve të Bashkuara ose organizatave të tjerave, ndërkombëtare, rajonale ose kombëtare, ose institucioneve, Komitetit të Kryqit të Kuq, Kryqit të Kuq Kombëtar dhe shoqëritë e Kryqit të Kuq dhe Federatës së tyre Ndërkombëtare, organizatave joqeveritare ose në një bazë bilaterale.

2. Secili Shtet Palë Kontraktues, në gjendje ta bëjë këtë, do të sigurojë ndihmën për kujdesin dhe rehabilitimin dhe riintegrimin social dhe ekonomik të viktimave të eksplozivave të mbetur nga lufta. Kjo ndihmë mund të sigurohet, *inter alia*, nëpërmjet sistemit të Kombeve të Bashkuara ose organizatave të tjera, ndërkombëtare, rajonale ose kombëtare, ose institucioneve, Komitetit të Kryqit të Kuq, Kryqit të Kuq Kombëtar dhe shoqëritë e Kryqit të Kuq dhe Federatës së tyre Ndërkombëtare, organizatave joqeveritare ose në një bazë bilaterale.

3. Secili Shtet Palë Kontraktues, në gjendje ta bëjë këtë, do të kontribuojë duke bashkuar fondet në sistemin e Kombeve të Bashkuara, si dhe në sisteme të tjera për të lehtësuar dhënien e ndihmës sipas këtij protokollit.

4. Secili Shtet Palë Kontraktues do të ketë të drejtë të marrë pjesë sa më shumë të jetë e mundur në shkëmbimin e pajisjeve, materialeve dhe informacionit teknologjik dhe shkencor, si dhe armët e lidhura me teknologjinë, të nevojshme për zbatimin e këtij protokollit. Shtetet Palë Kontraktuese marrin përsipër të lehtësojnë këto shkëmbime në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe të mos vendosin kufizime për klerancën e pajisjeve dhe informacionit teknologjik për qëllime humanitare.

5. Secili Shtet Palë Kontraktues merr përsipër të sigurojë informacion për këto të dhëna mbi aksionin minë të krijuar brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara, sidomos informacionin lidhur me mënyrat dhe teknologjinë e ndryshme të klerancës së eksplozivave të mbetur nga lufta, listën e ekspertëve, agjencitë e ekspertëve ose pikat kombëtare të kontaktit për klerancën e eksplozivave të mbetur nga lufta dhe në mënyrë vullnetare, informacionin teknik për tipet e ndryshme të artillerisë eksplozive.

6. Shtetet Palë Kontraktuese mund të paraqesin kërkesat për ndihmë kryesisht përmes informacionit dërguar Kombeve të Bashkuara ose organeve të duhura, ose shteteve të tjera.

Këto kërkesa mund t'i paraqiten Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do ta transferojë atë te të gjitha Shtetet Palë Kontraktuese dhe organizata ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare.

7. Në rast të kërkesave drejtuar Kombeve të Bashkuara, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, brenda mundësive të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, mund të marrë masat e nevojshme për vlerësimin e situatës dhe në bashkëpunim me kërkesën e Shteteve Palë Kontraktuese dhe shteteve të tjera kontraktuese me përgjegjësinë siç përcaktohet në nenin 3 të sipërpërmendur, rekomandon dhënien e ndihmës së duhur.

8. Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu mund t'i raportoje te Shtetet Palë Kontraktuese këto vlerësime, si dhe tipin dhe qëllimin e ndihmës që kërkohet, duke përfshirë kontributet e mundshme nga fondet e vendosura brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara.

#### Neni 9

##### **Masa të përgjithshme parandaluese**

1. Duke pasur në mendje situatat dhe aftësitë e ndryshme, secili Shtet Palë Kontraktues do të nxitet të marrë masa të përgjithshme parandaluese me qëllim minimizimin e efekteve të eksplozivave të mbetur nga lufta, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në mundësitë që parashikohen me pjesën 3 të aneksit teknik.

2. Secili Shtet Palë Kontraktues në bazë të vullnetare, mund të shkëmbyjë informacion lidhur me përpjekjet për të provuar dhe vendosur praktikatat më të mira në lidhje me paragrafin 1 të këtij neni.

#### Neni 10

##### **Konsultimet e Shteteve Palë Kontraktuese**

1. Shtetet Palë Kontraktuese marrin përsipër të konsultohen dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të gjitha çështjet lidhur me zbatimin e këtij protokollit. Për këtë qëllim, do të mbahet një konferencë e Shteteve Palë Kontraktuese kur palët bien dakord, por jo me më pak se 18 Shtete Palë Kontraktuese.

2. Puna e konferencave të Shteteve Palë Kontraktuese do të përfshijë:

- a) rishikimin e statusit dhe veprimit të protokollit;
- b) marrjen parasysh të çështjeve lidhur me zbatimin kombëtar të protokollit, duke përfshirë raportimet kombëtare ose azhurnimin në bazë vjetore;
- c) përgatitjen për konferenca rishikimi.

3. Shpenzimet për konferencat e Shteteve Palë Kontraktuese do të përballohen nga Shtetet Palë Kontraktuese dhe shtete jo palë që marrin pjesë në stërvitje, në përputhje me shkallën e vlerësimit të Kombeve të Bashkuara.

#### Neni 11

##### **Ankesat**

1. Secili Shtet Palë Kontraktues do të kërkojë që forcat e tij të armatosura dhe agjencitë ose departamentet e caktuara të nxjerrin udhëzimet e duhura dhe procedurat e zbatueshme dhe që personeli i tij të trajnohet në përputhje me dispozitat e këtij protokollit.

2. Shtetet Palë Kontraktuese marrin përsipër të konsultojnë njëri-tjetrin dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në nivel dypalësh, përmes Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara ose përmes procedurave ndërkombëtare, për të zgjidhur çdo konflikt që mund të lindë lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të këtij protokollit.

## ANEKSI TEKNIK

Aneksi teknik përmban praktikat më të mira që sugjerohen për arritjen e synimeve të parashikuara në nenet 4, 5 dhe 9 të këtij protokoll. Ky aneks teknik do të implementohet nga Shtetet Palë Kontraktuese vullnetarisht.

1. Regjistrimi, magazinimi dhe përhapja e informacionit për artilerinë e pashpërthyer dhe artilerinë eksplozive të lënë.

a) Regjistrimi i informacionit: lidhur me artilerinë eksplozive, e cila mund të jetë shndërruar në artileri eksplozive të lënë, një shtet duhet të regjistrojë sa më me kujdes dhe sa më shumë të jetë e mundur informacionet e mëposhtme:

- i) Vendndodhjen e zonave të përcaktuara ku përdoren artileri eksplozive;
- ii) Numrin e përafërt të artilerisë eksplozive të përdorur në zonat sipas paragrafit (i);
- iii) Tipin dhe llojin e artilerisë eksplozive të përdorur në zonat sipas paragrafit (i);
- iv) Vendndodhjen e përgjithshme të artilerisë së pashpërthyer të ditur dhe të mundshme;

Në rast se një shtet ka qenë i detyruar të lërë artileri eksplozive gjatë operacioneve, ai duhet të përpikt ta lërë artilerinë e pashpërthyer në një mënyrë të mbrojtur dhe të sigurt dhe të regjistrojë informacionin për këtë artileri.

- v) Vendndodhjen e artilerisë së pashpërthyer;
- vi) Sasinë e përafërt të artilerisë së pashpërthyer në secilën zonë;
- vii) Llojet e artilerisë së pashpërthyer në secilën zonë.

b) Depozitimi i informacionit: Nëse një shtet ka regjistruar informacionin në përputhje me paragrafin (a), ai duhet të ruhet në atë mënyrë që të lejojë tërheqjen dhe përhapjen në përputhje me paragrafin (c).

c) Përhapja e informacionit: Informacioni i regjistruar dhe i ruajtur nga një shtet në përputhje me paragrafët (a) dhe (b), duke pasur parasysh interesat e sigurisë dhe detyrime të tjera të shteteve që sigurojnë informacion, duhet të përhapen në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

i) Përmbajtja:

Përhapja e informacionit për artilerinë e pashpërthyer duhet të përmbajë detaje për:

- 1) vendndodhjen e përgjithshme të artilerisë së pashpërthyer të ditur dhe të mundshme;
- 2) llojet dhe tipet e artilerisë eksplozive të përdorura në zonat e caktuara;
- 3) metodën e identifikimit të artilerisë eksplozive duke përfshirë ngjyrën, masën, formën dhe shenja të tjera;
- 4) metodën për shkatërrimin e sigurt të artilerisë eksplozive.

Përhapja e informacionit për artilerinë eksplozive të lënë duhet të përmbajë detaje për:

- 5) vendndodhjen e artilerisë eksplozive të lënë;
- 6) numrin e përafërt të artilerisë eksplozive të lënë në çdo zonë;
- 7) llojet e artilerisë eksplozive të lënë në çdo zonë;
- 8) metodën e identifikimit të artilerisë eksplozive të lënë, duke përfshirë ngjyrën, masën dhe formën;

formën;

9) informacionin për llojin dhe metodën e paketimit të artilerisë eksplozive të lënë;

10) gjendjen e gatishmërisë;

11) vendin dhe llojin e ndonjë mine *booby-traps*, që dihet se ndodhet në zonën e artilerisë eksplozive të lënë.

ii) Marrësi: Informacioni duhet t'i jepet palës ose palëve që kanë kontroll në territoret e ndikuara dhe atyre personave ose institucioneve për të cilat shtetet janë dakord, ose që do të përfshihen në klerancën për artileri të pashpërthyer ose artileri eksplozive të lënë, në zonat e ndikuara, për edukimin e popullsisë civile për rreziqet e artilerisë së pashpërthyer ose artilerisë eksplozive të lënë.

iii) Mekanizimi: Një shtet, kur është e mundur, duhet të përdorë ato mekanizma, ndërkombëtarë ose lokalë, për përhapjen e informacionit, si përmes UNMAS, IMSMA dhe agjenci të tjera eksperte, që konsiderohen të përshtatshme nga shtetet lëshuese.

iv) Koha: Informacioni duhet të lëshohet sa më shpejt të jetë e mundur, duke pasur parasysh çështjet e operacionet ushtarake dhe humanitare në zonat e ndikuara, gatishmërinë dhe mbrojtjen e informacionit dhe çështjet përkatëse të sigurisë.

## 2. Paralajmërimet, edukimi, shënjimi, rrethimi dhe monitorimi

### Termat kryesorë

a) Paralajmërimet janë dispozita të sakta të informacionit të kujdesshëm që i jepet popullsisë civile, që kanë për qëllim të minimizojnë rreziqet e shkaktuara nga eksplozivat e mbetur nga lufta në territoret e prekura.

b) Edukimi i popullsisë civile duhet të konsistojë në programet e edukimit për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit mes komuniteteve të prekura, autoritetet qeveritare dhe organizatave humanitare, kështu komunitetet e prekura janë të informuara rreth kërcënimit nga mbetjet eksplozive të luftës. Programet e edukimit janë zakonisht me afat të gjatë.

Elementet e praktikave më të mira për paralajmërimet dhe edukimin, .

c) Gjithë programet e paralajmërimit dhe të edukimit nëse është e mundur duhet të marrin parasysh standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe standardet ndërkombëtare të aksionit antiminë.

d) Paralajmërimet dhe edukimi duhet t'i sigurohen popullsisë civile të prekur, e cila përfshin civilë që jetojnë në ose përreth që përmbajnë eksploziva të mbetur nga lufta dhe civilë që kalojnë nëpër këto zona.

e) Paralajmërimet duhet të jepen sa më shpejt të jetë e mundur, duke pasur parasysh kontekstin dhe informacionin e disponueshëm. Një program edukimi duhet të zëvendësojë një program paralajmërimi sa më shpejt të jetë e mundur. Paralajmërimet dhe edukimi duhet të sigurohen për komunitetet e prekura sa më shpejt të jetë e mundur.

f) Palët në një konflikt duhet të punësojnë palë të treta si organizata ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare kur kanë burimet e mjaftueshme dhe aftësitë për të shpërndarë programe edukimi efëcente.

g) Palët në një konflikt duhet, nëse është e mundur, të sigurojnë burime shitesë për paralajmërimet dhe programe edukimi. Këto mund të përfshijnë: dispozita për mbështetjen logjistike, prodhimin e materialeve të programit të edukimit, mbështetje financiare dhe informacionin e përgjithshëm kartografik.

Shënjimi, rrethimi dhe monitorimi i një zone të prekur nga eksplozivat e mbetur nga lufta.

h) Kur është e mundur, në çdo kohë gjatë periudhës së konfliktit dhe më pas, ku ekzistojnë mbetjet eksplozive nga lufta, palët në konflikt duhet, në kohën sa më të shkurtër të mundshme dhe sa më shumë të jetë e mundur, të sigurojnë që zonat që përmbajnë eksploziva të mbetur nga lufta, janë të shënjuar, të rrethur dhe të kontrolluar në mënyrë që të përjashtojnë në mënyrë efektive civilët, në përputhje me dispozitat e mëposhtme.

i) Shenjat paralajmëruese për metodat e shënjitimit të njohura nga komuniteti i prekur do të përdoren për shënjimimin e zonave që dyshohen si të rrezikshme. Shenjat dhe shënimet e zonave të rrezikshme të rrethuara duhet sa më shumë të jetë e mundur, e lejueshme, rezistuese për ndikimet mjedisore dhe duhet të përcaktojnë saktë se cila anë e saj konsiderohet të jetë brenda zonave të prekura nga eksplozivat e mbetur nga lufta dhe cila anë e saj konsiderohet të jetë e sigurt.

j) Një strukturë e përshtatshme duhet të krijohet me përgjegjësi për monitorimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve shënjuese të përhershme dhe të përkohshme, të integruara me programet kombëtare të edukimit.

## 3. Masa të përgjithshme parandaluese

Shtetet që prodhojnë dhe prokurojnë artileri eksplozive duhet, sa më shumë të jetë e mundur dhe brenda mundësive, të përpiqen të sigurojnë që masat e mëposhtme janë zbatuar dhe respektuar gjatë ciklit të artilerisë eksplozive.

a) Menaxhimi i prodhimit të municioneve

i) Proceset e prodhimit duhet të dezinjohen në atë mënyrë që të arrijnë efektivitetin më të madh të municioneve.

ii) Proceset e prodhimit duhet të jenë subjekt i masave të certifikuar të kontrollit të cilësisë.

iii) Gjatë prodhimit të artilerisë eksplozive, duhet të zbatohen standardet ndërkombëtare të certifikuar të sigurisë së cilësisë.

iv) Testimi i pranimit duhet të kryhet përmes testimit të drejtpërdrejtë të kushteve ose përmes procedurave të tjera të vlerësimit.

v) Standarde të larta duhet të kërkohen gjatë kryerjes së transaksioneve dhe transfertat e artilerisë eksplozive.

b) Menaxhimi i municioneve

Në mënyrë që të sigurohet efektiviteti më i mirë i mundshëm afatgjatë i artilerisë eksplozive, shtetet duhet të inkurajohen të zbatojnë normat e praktikave më të mira dhe procedurat zbatuese përse i përket magazinimit, transportit, magazinimit në fushë dhe ruajtjes në përputhje me të dhënat e mëposhtme:

i) Artileria eksplozive, nëse është e mundur, duhet të depozitohet në vendet me lehtësira ose kontenerë të duhur që mbrojnë artilerinë eksplozive dhe përbërësit e tij në një atmosferë të kontrolluar nëse është e nevojshme.

ii) Një shtet duhet të transportojë artileri eksplozive nga dhe për në vendet me lehtësirat, vendet e depozitimit dhe fushën në një mënyrë që minimizon dëmet e artilerisë eksplozive.

iii) Kontenerët e duhur dhe për kontrollin e mjedisit, nëse është e nevojshme, duhet të përdoren nga një shtet gjatë magazinimit dhe transportimit të artilerisë eksplozive.

iv) Rreziku i shpërthimeve në stoqet duhet të minimizohet nga përdorimi i rregullimeve të duhura të stoqeve.

v) Shtetet duhet të zbatojnë procedurat e duhura për ruajtjen dhe testimin e artilerisë eksplozive, të cilat duhet të përfshijnë informacion për datën e prodhimit të secilit numër, sasinë e artilerisë eksplozive dhe informacion se ku ka qenë artileria eksplozive, në cilat kushte është magazinuar dhe në cilët faktorë mjedisorë është ekspozuar.

vi) Në mënyrë periodike, artileria eksplozive e lënë në toqe, duhet t'i nënshtrohet, nëse është e mundur, testimit me ndezje për të siguruar funksionet e dëshiruara të municioneve.

vii) Nënansambletë e artilerisë eksplozive të lëna në stoqe duhet, nëse është e mundur, t'i nënshtrohen testimit laboratorik për të siguruar funksionet e dëshiruara të municioneve.

viii) Nëse nevojitet, veprimet e duhura, duke përfshirë axhustimin e artilerisë së dyshuar, duhet të merren si rezultat i informacionit të kërkuar nga procedura e ruajtjes dhe testimit në mënyrë që të ruhet siguria e artilerisë eksplozive të lënë stok.

c) Trajnimi

Trajnimi i duhur i të gjithë personelit të përfshirë në ruajtjen, transportimin dhe përdorimin e artilerisë eksplozive është një faktor i rëndësishëm për të siguruar operacionin sipas qëllimit të përcaktuar. Shtetet këtu duhet të adoptojnë dhe mirëmbajnë programe të përshtatshme trajnimi për të siguruar që personeli është i trajnuar siç duhet në lidhje me municionet me të cilat ata do të kenë punë.

d) Transferimi

Një shtet që planifikon t'i transferojë artileri eksplozive një shteti tjetër që nuk ka pasur në përdorim atë lloj artilerie duhet të përpiqet të sigurojë që shteti marrës ka aftësinë të magazinonjë, ruajë dhe përdorë atë artileri eksplozive në mënyrën e duhur dhe korrekte.

dh) Prodhimi i ardhshëm

Një shtet duhet të ekzaminojë rrugët dhe mënyrat për sigurimin e artilerisë eksplozive të cilën ka për qëllim të prodhojë ose prokurojë, me qëllim që të arrijë sigurimin më të lartë të mundshëm.

**UDHËZIM**  
**Nr. 1, datë 20.2.2006**

**PËR NDRYSHIMIN E KATEGORISË SË TOKËS BUJQËSORE DHE KATEGORIZIMIT  
TË RESURSEVE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 7 të ligjit nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” me propozim të Drejtorisë së Menaxhimit të Tokave dhe të Ujërave,

**UDHËZOJ:**

**I. PËR NDRYSHIMIN E KATEGORISË SË TOKËS NË RASTET E DËMTIMIT TË CILËSIVE TË TOKAVE SI REZULTAT I VEPRIMIT TË FAKTORËVE FUQI MADHORE.**

1. Pronari i tokës bujqësore dhe posedues të ligjshëm të saj, në sipërfaqen e të cilit kanë vepruar faktorë natyrorë të fuqisë madhore si tërmete, rrëshqitje masive të sipërfaqes së tokës, përmytje masive etj. të kësaj natyre mund të ushtrojnë kërkesë pranë strukturave shtetërore të ngarkuara me ligj për administrimin dhe mbrojtjen e tokës për verifikimin dhe ndryshimin e kategorisë së tokës.

Veprimi i faktorëve natyrorë të fuqisë madhore duhet të jetë i dokumentuar me procesverbalin e kohës së dëmtimit dhe i konfirmuar nga ekspertë të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit, si dhe përfaqësuesi i Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZMMT) në komunë dhe/ose bashki.

2. Në kërkesë duhet të pasqyrohet:

a) Pozicioni gjeografik i parcelës (genplani ose harta treguese, nr.parcelës, emërtimi).

b) Dokumentacioni i pronësisë (tapi, certifikatë nga zyra e regjistrimit).

c) Shkaqet e dëmtimit të cilësive të tokës, shoqëruar me procesverbalin e mbajtur në kohën e veprimit të faktorëve fuqi madhore.

3. Kërkesa konfirmohet nga kryetari i komunës dhe/ose bashkisë dhe drejtohet për ndjekjen e procedurave në Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (SAMT) në qark.

4. SAMT, mbasi verifikon elementet e kërkesës, i propozon Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për ndryshimin e kategorisë së tokës.

5. Drejtoria e Menaxhimit të Tokës dhe të Ujërave, në MBUMK krijon grupin e ekspertëve me përbërje: dy specialistë të Institutit të Studimit të Tokave, (IST), një specialist i SAMT dhe një specialist i ZMMT në komunë dhe/ose bashki.

6. IST harton dhe miraton procedurat teknike dhe analizat kimike të domosdoshme për vlerësimin e tokës bujqësore.

7. Grupi i ekspertëve brenda një muaji verifikon në parcelë elementet e kërkesës, hap profile dhe merr mostra toke sipas procedurave të miratuara.

8. Pronari ose posedues të tjerë të ligjshëm që kanë bërë kërkesën, i përballojnë shpenzimet e punës para fillimit të procedurave dhe paguajnë në llogari të Institutit të Studimit të Tokave, vlerën e analizave kimike që do të kryhen.

9. Mbas përfundimit të analizave, grupi i ekspertëve bën llogaritjet, harton raportin teknik dhe i dërgon mendimin Drejtorisë së Menaxhimit të Tokave dhe të Ujërave për miratim ose jo të kërkesës.

10. Drejtoria e Menaxhimit të Tokave dhe të Ujërave shqyrton materialin dhe, nëse e gjen të plotë, ia paraqet për miratim Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Kur materialit të paraqitur i mungojnë argumentet e duhura, DMTU urdhëron riverifikimin dhe rivlerësimin me një grup tjetër specialistësh.

11. Ndryshimi i kategorisë së tokës bujqësore në regjistrat e bonitetit bëhet vetëm mbas miratimit nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

## II. PËR NDRYSHIMIN E KATEGORIZIMIT TË RESURSEVE

1. Pronari ose institucioni që e ka në administrim ose pronësi resursin, duhet të bëjë kërkesë me shkrim për ndryshimin e kategorizimit të resursit, bazuar në procedurat e parashikuara në pikën 1 dhe 6 të kreut të III-të të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.532, datë 30.10.2002 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve në seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit të mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki”.

2. Kërkesa për ndryshimin e kategorizimit të resursit duhet të përmbajë:

- a) pozicionin gjeografik të parcelës (hartën, numrat e parcelave, emërtimin);
- b) Gjendjen aktuale të zërit kadastral;
- c) Dokumentin e pronësisë ose vërtetimin nga SAMT ose ZRPP mbi gjendjen e pronësisë;
- d) Studimin i cili argumenton kërkesën dhe ndikimin në fushën mjedisore, ekonomike e sociale të zonës;
- e) Miratimin nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Drejtoria e Shërbimit Pyjeve dhe Kullotave dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit.

3. Pas miratimit në parim nga këshilli i komunës, kërkesa i përcillet për miratim SAMT në qark.

4. Këshilli i qarkut në orientim të strategjisë së zhvillimit të qarkut, shqyrton kërkesën dhe në rast se e miraton atë në parim, e përcjell të miratuar dhe argumentuar në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. MBUMK me urdhër të veçantë krijon grupin e ekspertëve në përbërje të të cilit janë dy specialistë nga IST, një specialist nga SAMT dhe një specialist nga ZMMT në komunë dhe/ose bashki.

6. IST në bashkëpunim me DPPK përcaktojnë procedurat teknike dhe llojin e analizave të domosdoshme për realizimin e ndryshimit të kategorizimit të resurseve.

7. Grupi i ekspertëve brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës zbaton procedurat teknike dhe verifikon elementet e kërkesës.

8. Në përfundim të analizave grupi i ekspertëve, në bashkëpunim me specialistin e ZMMT në komunë dhe/ose bashki dhe specialistin e SAMT në qark, harton raportin teknik dhe shpreh mendimin për miratim ose jo të kërkesës në Drejtorinë e Menaxhimit të Tokave dhe të Ujërave.

9. DMTU propozimin ia paraqet për miratim Ministrit.

10. Ndryshimi i kategorizimit të resursit pasqyrohet në librin kadastral të SAMT, vetëm mbas miratimit nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

11. Pronari ose institucioni që paraqet kërkesën paraprakisht bën likuidimin pranë IST-së të shpenzimeve për punën e grupit të ekspertëve dhe vlerën e analizave sipas tarifave të përcaktuara në rregulloren e IST-së.

## III PËR KRYERJEN E ANALIZAVE TË TOKËS BUJQËSORE, PËR RASTET KU NUK KANË TË DHËNA PËR SHKALLËN E BONITETIT.

1. Komunat dhe/ose bashkitë, për efekt të ushtrimit të veprimtarisë së tyre funksionale, siç janë praktikat e taksimit, të shpronësimit për interes publik etj., përcaktojnë të gjitha sipërfaqet, tokës bujqësore, për të cilat mungojnë të dhënat për shkallën e bonitetit, si rezultat i mospërfshirjes së tyre në studimin përkatës, bëjnë paraqitjen grafike të tyre dhe e dërgojnë në SAMT në qark, me kërkesën për përcaktimin e bonitetit.

2. SAMT në qark shqyrtojnë kërkesën duke e verifikuar me të dhënat që ka në librin e bonitetit

3. Pas verifikimit dhe kur rezultojnë që nuk ekzistojnë të dhënat e studimit për shkallën e bonitetit i drejtohen IST për të kryer analizat.

Kur sipërfaqja e përgjithshme e personave në një komunë që kërkojnë studimin e bonitetit është nën 50 ha kërkesa i paraqitet direkt IST.

Kur sipërfaqet janë mbi 50 ha, përgjegjësi i SAMT në qark dhe kryetari i komunës hartojnë aktmarrëveshje të përbashkët me IST për kohën e kryerjes së studimit dhe kushteve të tjera.

4. IST pas marrëveshjes së arritur organizon grupin e ekspertëve, për kryerjen e studimit sipas metodikës së miratuar.

5. Pas daljes së rezultateve të analizave, nga grupi i ekspertëve, përpunohen të dhënat dhe hartohet aktvlerësimi.

6. Komunitet dhe/ose bashkitë kryejnë likuidimin paraprak të shpenzimeve për vlerën e kryerjes së analizave sipas tarifave të përcaktuara në rregulloren e IST.

7. Pas daljes së rezultatit përfundimtar, nga përpunimi i të dhënave, përkrahimi fushor dhe përpilimi i aktvlerësimit, IST i dërgon zyrtarisht në Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark dhe Zyrat e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në komunë dhe/ose bashki. Kopja tjetër e të dhënave ruhet në arkivin e IST.

8. Seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki hedhin të dhënat në librin e bonitetit.

Udhëzimi nr.1315, datë 14.4.2004 “Për ndryshimin e kategorizimit të tokës bujqësore dhe kategorizimit të resurseve”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT  
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT  
Jemin Gjana

#### UDHËZIM

Nr. 4, datë 28.2.2006

#### PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË VLERËSIMIT DHE AKREDITIMIT PËR SHKOLLAT E LARTA JOPUBLIKE

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës, nenet 10 dhe 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), në pikën 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.303, datë 1.7.1999 “Për krijimin e Sistemit të Akreditimit në Arsimin e Lartë”, i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.611, datë 4.12.2002 “Për një ndryshim në vendimin nr.303, datë 1.07.1999, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Sistemit të Akreditimit në Arsimin e Lartë”, në pikën 3/b të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.156, datë 22.3.2001 “Për shkollat e larta jopublike në Republikën e Shqipërisë dhe në pikën 1/c të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.07.1998 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”

#### UDHËZOJ:

1. Tarifa për vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin e shkollave të larta jopublike të jenë si më poshtë:

a) Tarifa bazë për vlerësimin dhe akreditimin akademik dhe institucional për çdo program, kurs studimi apo njësi të arsimit të lartë që vlerësohet në mënyrë individuale të jetë 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë.

b) Tarifa për vlerësimin dhe akreditimin e njëkohshëm të dy ose më shumë programeve/diplomave/njësive të arsimit të lartë me trung të përbashkët të shtohet me 25% të tarifës bazë për çdo program/diplomë shtesë.

c) Në rastet kur kërkohet pjesëmarrja e një eksperti të huaj në vlerësim, pagesa e tij llogaritet mbi tarifën e parashikuar në pikën 1/a dhe 1/b, dhe përballohet nga shkolla e lartë jopublike që ka kërkuar vlerësimin.

2. Tarifa për çdo vlerësim, e llogaritur sipas pikave 1/a dhe 1/b të këtij udhëzimi, arkëtohet paraprakisht, në llogarinë buxhetore të Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë.  
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE I SHKENCËS  
Genc Pollo

**VENDIM**  
Nr. 4, datë 25.1.2006

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË SË ERE-S DHE  
GJENDJEN E SEKTORIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE NË SHQIPËRI PËR VITIN 2005**

Në zbatim të neneve 9 dhe 10, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, në mbledhjen e tij të datës 25.01.2006, pasi shqyrtoi raportin vjetor të ERE-s “Veprimtaria e ERE-s dhe gjendja e sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri për vitin 2005”, të paraqitur nga kryetari i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin vjetor të ERE-s “Veprimtaria e ERE-s dhe gjendja e sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri për vitin 2005”, që do t’i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë. (Raporti bashkëngjitur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S  
Pjetër Dema



**RAPORT VJETOR**  
VEPRIMTARIA E ERE-s DHE GJENDJA E SEKTORIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE NË  
SHQIPËRI PËR VITIN 2005

**Hyrje**

Veprimtaria e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike ( ERE ), gjatë vitit 2005, ka pasur si objektiv kryesor vazhdimin e punës për zbatimin e *ligjit nr.9072 datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”*, në lidhje me hartimin e legjislacionit sekondar, si një kërkesë e domosdoshme për zhvillimin e sektorit elektroenergjitik në Shqipëri në përputhje dhe me kërkesat dhe standardet që kërkon BE-ja. ERE gjatë vitit të dytë të funksionimit të saj pas daljes së ligjit të ri të lartpërmendur të sektorit të energjisë elektrike, ka punuar për konsolidimin e saj dhe forcimin e rolit dhe veprimtarisë së vet si institucion i pavarur dhe i paanshëm në përputhje me ligjin. ERE ka bashkëpunuar në mënyrë shumë korrekte me partnerë ndërkombëtarë shumë të rëndësishëm, si: USAID (US Agency for International Development), BB (World Bank),ERRA (Energy Regulators Regional Association), CEER (Council of European Energy Regulators) dhe NARUC (National Association of Regulatory Utility Commissioners), ndihma e të cilëve ka qenë shumë e vlefshme. ERE gjithashtu ka zhvilluar një bashkëpunim të frytshëm me të gjithë pjesmarrësit e sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri.

**I. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ERE-s NË ZBATIM TË LIGJIT “PËR SEKTORIN E ENERGIJË ELEKTRIKE”**

ERE funksionon sipas strukturës organizative të paraqitur më poshtë:



Struktura organizative e ERE-s, për të cilën ne kemi dhënë shpjegime të hollësishme në raportin e paraqitur vjet, është ruajtur e njëjtë në numër. Qëllimi ynë ka qenë rritja e kapacitetit profesional, e aftësive teknike e administrative të personelit dhe Bordit të Komisionerëve dhe në tërësi rritja e efikasitetit të punës së tyre. Ne kemi synuar që në radhë të parë të bashkëpunojmë me ekspertët e huaj konsulentë të financuar nga USAID, për hartimin e akteve të reja nënligjore më të rëndësishme, për të shfrytëzuar sa më mirë përvojën e tyre në fushën e legjislacionit, për rrjedhojë rezultatet kanë qenë të mira. Ne gjithashtu kemi bashkëpunuar shumë ngushtë edhe me ekspertët dhe specialistët më të kualifikuar të pjesëmarrësve të sektorit të energjisë elektrike dhe kryesisht të shoqërive elektroenergjetike brenda vendit, për hartimin e këtyre akteve nënligjore.

Bordi i Komisionerëve dhe personeli teknik i ERE-s, gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet, ka zbatuar në mënyrë korrekte legjislacionin në fuqi dhe detyrat e përcaktuara në tri dokumente bazë, si më poshtë:

- 1) Kodin e Etikës dhe Rregulloren e Funkcionimit të Bordit të ERE-s.
- 2) Rregulloren për Organizimin, Drejtimin, Funkcionimin dhe Detyrat e ERE-s.

3) Kodin e Sjelljes për Personelin Teknik dhe Punonjësit e Tjerë të ERE-s.

Me aktet nënligjore të hartuara dhe miratuara nga ERE gjatë vitit 2005, është realizuar miratimi në masën 80% të akteve që kërkon ligji, duke krijuar mundësitë e plota ligjore:

- a) për hapjen e tregut dhe funksionimin normal të tij;
- b) për arritjen e standarteve të reja në shërbimin ndaj konsumatorit;
- c) për licencimin e investitorëve që kanë interes për të investuar në ndërtimin e burimeve të reja të vogla gjeneruese;
- d) për miratimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike dhe të tarifave të shërbimit të transmetimit;
- e) si dhe për monitorimin dhe mbikëqyrjen e plotë të tregut të energjisë elektrike në vend dhe të zhvillimeve të tij.

ERE ka funksionuar mbi bazën e një buxheti, të ardhurat e të cilit, në zbatim të ligjit për energjinë, krijohen nga pagesat e rregullimit që bëjnë të licencuarit, sipas koeficientit të përcaktuar prej saj, në mënyrë transparente dhe bazuar në rregulla e standarde që nuk lejojnë diskriminim.

## **II. VEPRIMTARIA ERE-S GJATË VITIT 2005**

Veprimtaria e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike për vitin 2005, ka pasur si objektiv kryesor vazhdimin e punës për hartimin dhe miratimin e kuadrit ligjor që i shërben kryerjes së reformës në sektorin elektroenergetik shqiptar. Në mënyrë më të detajuar, këtë veprimtari mund ta shprehim në këto drejtime kryesore:

- 1) Kuadri ligjor
- 2) Përgatitja e rregullave dhe standardeve për miratimin e çmimeve;
- 3) Zbatimi i rregullave dhe procedurave për licencimin, monitorimin dhe veprimtarinë e eksportit dhe importit të energjisë elektrike;
- 4) Bashkëpunimi me partnerët jashtë vendit
- 5) Aspekti financiar dhe administrimi në ERE.


### **II.1 Veprimtaria e ERE-s për hartimin e kuadrit ligjor**

Veprimtaria e ERE-s për hartimin e kuadrit ligjor ka pasur parasysh zbatimin e kërkesave të ligjit “Për rektorin e energjisë elektrike” që hyri në fuqi më 18 korrik 2003. Ky ligj e ngarkon ERE-n me përgjegjësinë e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore, të cilat i shërbejnë rregullimit dhe funksionimit sa më mirë të sektorit të energjisë elektrike. Ashtu si dhe vetë ky ligj, legjislacioni sekondar i miratuar nga ERE përbën një bazë të rëndësishme për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, hapjen e kontrolluar të tij, zhvillimin e konkurrencës dhe përmirsimin e cilësisë së shërbimit, si dhe i shërben kryerjes me sukses të reformës së filluar në sektorin elektroenergetik.

**Në zbatim të ligjit, ERE duhet të miratojë 29 akte nënligjore për sektorin e energjisë elektrike.** Ligji jo për të gjitha ka përcaktuar afate, por ERE ka mbajtur parasysh nevojat prioritare që ka pasur zhvillimi i sektorit të energjisë elektrike. Bordi i Komisionerëve së bashku me personelin teknik të ERE-s, nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë me pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike brenda vendit, si dhe me ekspertë të kualifikuar në fushën e energjisë elektrike të kompanive prestigjioze ndërkombëtare konsulente të financuara nga USAID, të cilat kanë dhënë konsulencë teknike në hartimin e një legjislacioni të tillë të ngjashëm pothuaj në të gjitha vendet e rajonit, **miratuan gjatë këtyre dy viteve 29 akte nënligjore gjithsej, 22 nga të cilat ishin kërkesë e ligjit**, ndërsa 7 akte të tjera nënligjore u miratuan, si një nevojë e domosdoshme në kushtet aktuale të zhvillimit të sektorit, që mbase për arsye eksperience nuk ishin parashikuar në ligjin e ri për sektorin e energjisë elektrike. Vetëm gjatë vitit 2005, ERE miratoi 14 akte nënligjore mjaft të rëndësishme, si më poshtë:

1. Rregullat e tregut të energjisë elektrike;
2. Licencë për importin e energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
3. Licencë e furnizuesit të kualifikuar për furnizimin me energji elektrike të klientëve të kualifikuar;
4. Licencë për furnizimin me energji elektrike të klientëve tariforë;
5. Rregullore për procedurat e heqjes së një licence;
6. Metodologjia e llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit;
7. Metodologjia e llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike;

8. Metodologjia e llogaritjes së tarifave të shitjes për klientët tariforë;
9. Udhëzues metodik për vlerësimin nga ERE të investimeve që kryejnë të licencuarit në hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 5 MW si dhe në h/c e Smokthinës;
10. Kodi i funksionimit të shpërndarjes së energjisë elektrike;
11. Kontrata e furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjarë;
12. Kontrata e furnizimit me energji elektrike të klientëve të kategorisë jofamiljarë;
13. Kodi i matjes së energjisë elektrike;
14. Rregullore për procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit të Komisionerëve.



Të gjitha këto akte nënligjore janë botuar ne Fletoren Zyrtare si pjesë e procesit të zbatimit të ligjit dhe nuk është kontestuar asnjë prej tyre. Me aktet nënligjore të miratuara gjatë vitit 2005, ERE ka zbatuar një nga detyrat e caktuara në **Rezolutën e Kuvendit të datës 2.3.2005 në lidhje me “Veprimtarinë e ERE-s gjatë vitit 2004”**, sipas së cilës prioritet në punën e saj ERE duhet të ketë vazhdimin e procesit për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit për sektorin e energjisë elektrike.

Bordi i Komisionerëve gjatë vitit 2005 ka marrë 85 vendime kundrejt 60 vendime që janë marrë një vit më parë. Këto vendime janë marrë për miratimin e akteve nënligjore të lartpërmendura në zbatim të ligjit, si dhe për çështje të tjera të rëndësishme të sferës së rregullimit të sektorit të energjisë elektrike, të fushës së licencimit, hapjes së tregut, kontrollit për plotësimin e detyrimeve që të licencuarit kanë ndaj konsumatorit, miratimit të tarifave dhe çmimeve, etj. Nga të gjitha këto vendime të ERE-s, vetëm në një rast ka pasur ankimum në Gjykatë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e ERE-s.

## II.2 Veprimtaria e ERE-s në fushën e tarifave dhe çmimeve

Përgatitja e rregullave dhe standardeve për miratimin e çmimeve dhe tarifës së shërbimit të transmetimit, ka qenë një drejtim tjetër mjaft i rëndësishëm i punës së ERE-s gjatë vitit 2005. Në bashkëpunim me konsulentët e huaj, por edhe me ekspertët e KESH sh.a. dhe OST sh.a. për një periudhë gati 5-mujore, u përgatitën dhe u miratuan metodologjitë e llogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga kompanitë e prodhimit, shpërndarjes dhe për konsumatorët tariforë. Këto metodologji janë të standardeve të njejta me metodologjitë që aplikojnë dhe vendet e tjera të rajonit.

Në dokumentet strategjike të miratuara nga Qeveria shqiptare, të cilat më parë se të miratoheshin janë konsultuar dhe me donatorët dhe institucione të rëndësishme financiare ndërkombëtare, si:

- 1) **Dokumenti i politikës së sektorit elektroenergjitik (prill 2002)**
- 2) **Strategjia kombëtare e energjisë (qershor 2003)**
- 3) **Modeli tranzitor i tregut të energjisë elektrike (gusht 2004)**

kërkohet vazhdimi i reformës tarifore për energjinë elektrike, sepse çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike është më i ulët se kostoja marxhinale dhe ekziston ndërsuvencionimi sektorial, për shkak se çmimi për konsumatorët familjarë është shumë i ulët në raport me çmimet e larta që mbahen për konsumatorët jofamiljarë.

Kështu që aplikimi korrekt i metodologjive të miratuara e eliminon këtë difekt, nëse edhe Qeveria do të merrte në konsideratë subvencionimin vetëm të konsumatorëve familjarë në nevojë.

Në lidhje me çmimin e shitjes së energjisë elektrike dhe stabilitetin e tij, vëmendja e donatorëve, por edhe e investitorve të ardhshëm vendas dhe të huaj është shumë e madhe, për të mos patur risk nëse ata investojnë në këtë fushë në Shqipëri. ERE u përgatit që në muajt korrik-gusht 2005 për të pritur aplikimin nga KESH sh.a për çmimin e shitjes së energjisë elektrike të vitit 2006. Megjithëse u paraqit një aplikim formal, KESH sh.a. pasi u ballafaqua me një situatë kritike lidhur me furnizimin e konsumatorëve me energji elektrike në fillim të muajit nëntor, vendosi të tërheqë aplikimin e bërë për një rritje të re të çmimit, por duke kërkuar të drejtën që të aplikojë në një kohë të përshtatshme pas muajve të parë të vitit 2006.

Siç e theksova dhe më lart, çmimin e shitjes së energjisë elektrike në Shqipëri vazhdojmë ta kemi më të ulët se kostoja megjithë përmirësimet e bëra. Sipas *strategjisë kombëtare të energjisë*, bazuar në studimin e kryer nga DECON me financim të Bankës Botërore, pranohet një kosto marxhinale prej **12,18 lekë/kWh**, e cila duhet të mbulohet nga një çmim i shitjes së energjisë elektrike prej **9,33 lekë/kWh**, duke marrë në konsideratë moskthimin e investimeve të bëra në sektorin elektroenergetik me fonde të Buxhetit të Shtetit para viteve 90. Kërkesat e strategjisë kombëtare të Energjisë shprehen qartë nëse i referohemi tabelës së mëposhtme:


Nr.	Konsumatorët	Çmimi i miratuar nga ERE (leke/kWh) për vitin 2005 :	Kërkesa e miratuar në strategjinë kombëtare të energjisë për çmimin sipas viteve (leke/kWh):		
			Viti 2005	Viti 2006	Viti 2015
1.	Konsumator në TL	8,30	5,52	6,00	6,61
2.	Familjarët	5,95	8,03	8,73	9,62
3.	Industria	8,45	7,55	8,20	9,04
4.	Tregti-Shërbime	11,00	8,53	9,27	10,21
5.	Ujësjiellës	7,15	6,99	7,60	8,37
	<b>Çmimi mesatar</b>	<b>7,01</b>			

Zhvillimi i reformës tarifore sidomos për konsumatorët familjare, bëhet akoma më adekuat, për faktin se tashmë KESH sh.a. ka përfunduar procesin e rivlerësimit të të gjitha aseteve gjë që sjell një impakt jo të vogël në rritjen e kostos, si dhe për faktin tjetër se pas vitit 2007 duhet hequr subvencionimi ndërsektorial. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, paraqitet sipas kësaj tablele:


Nr. Rend.	Emërtimi	Çmimi lekë/kWh Viti 2003	Çmimi lekë/kWh Viti 2004	Çmimi lekë/kWh Viti 2005
1	Mesatarisht për Konsumatorin Familjare <ul style="list-style-type: none"> <li>• Deri në 300 kWh/muaj</li> <li>• Mbi 300 kWh/muaj</li> </ul>	<b>5,17</b> 4,10 8,80		
2	Mesatarisht për konsumatorin familjarë <ul style="list-style-type: none"> <li>• Deri në 220 kWh/muaj</li> <li>• Mbi 220 kWh/muaj</li> </ul>		<b>5,93</b> 4,50 8,90	
3	Mesatarisht për konsumatorin familjarë <ul style="list-style-type: none"> <li>• Deri në 210 kWh/muaj</li> <li>• Mbi 210 kWh/muaj</li> </ul>			<b>5,95</b> 4,50 9,00


Nëse do të vazhdohet të mbahen çmime të larta të shitjes së energjisë elektrike për konsumatorët jofamiljarë, për shkak të mbajtjes së çmimit të ulët për konsumatorët familjarë për arsye sociale, atëherë bizneset do të dëmtoheshin dhe do të frenohej zhvillimi i tyre në të ardhmen. ERE ka paraqitur qëndrimin e saj dhe argumentet e nevojshme, se mbajtja e skemës së miratimit të çmimit për konsumatorët familjarë, të ndarë me dy blloqe konsumi, duhet të konsiderohet e kaluar dhe që tashmë nuk ka dhënë efekte pozitive, në lidhje me kursimin e përdorimit të energjisë elektrike. Më poshtë, do të shikojmë strukturën e çmimeve për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë në vendet e tjera të rajonit:

Average Electricity Price (Excluding Taxes) for Non-Residential Customers in ERRA Member Countries



Average Electricity Price (Including Taxes) for Residential Customers in ERRA Member Countries





Megjithatë, niveli i çmimeve të miratuara nga ERE për KESH sh.a. këto dy vitet e fundit, e kombinuar kjo natyrisht dhe me hapat progresive që janë bërë nga kjo shoqëri në drejtim të administrimit global të saj, kanë sjellë ndërprerjen e subvencionimit nga Buxheti i Shtetit për blerjen e energjisë së importit dhe në tërësi një rentabilitet të kënaqshëm. Kështu, rentabiliteti tregtar **ROS** është afërsisht rreth 9 % [Fitim/Të ardhura nga shitja], rentabiliteti financiar **ROE** rreth 8,2 % [Fitim/Kapital aksionar] dhe rentabiliteti ekonomik **ROI** rreth 3,5 % [Fitim/Totali i aktiveve].

### II.3 Veprimtaria e ERE-s për licencimin dhe monitorimin e veprimtarive të licencuara

Detyrat e ERE-s në zbatim të ligjit në lidhje me licencimin e aplikuesve në aktivitetet e sektorit të energjisë elektrike, monitorimin e zhvillimit të këtyre aktivitetëve, analizën e programit të investimeve dhe marrëveshjeve për blerjen e energjisë elektrike duke synuar drejt parimit të kostos më të ulët dhe ruajtjes së balancës në sektor, mbrojtjen e të licencuarve dhe konsumatorëve, si dhe mbikëqyrjen e të licencuarve për përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, në përgjithësi janë realizuar në nivel të mirë.

Gjatë vitit 2005 u shqyrtuan dhe u realizuan një sërë procesesh për licencimin e disa shoqërive në aktivitete të ndryshme të sektorit të energjisë elektrike. Procesi i nisur gjatë fundit të vitit 2004 për ndërmarrjen e hapave të para për hapjen e tregut të energjisë elektrike në vend u çua më përpara. Në kuadër të këtij procesi u licencua shoqëria “GSA” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar dhe importit të energjisë elektrike. Gjithashtu po gjatë kësaj periudhe në vijim të objektivave dhe rregullave të përcaktuara në Memorandumin e Athinës me synimin që në mënyrë progresive të sigurohet integrimi në Tregun Rajonal të Energjisë të Europës Juglindore, u trajtua kërkesa dhe iu dha Statusi i Klientit të Kualifikuar kompanisë “Kurum International” sh.p.k. Kështu numri i klientëve të kualifikuar në vend arriti në dy “Kurum International” sh.p.k. dhe “Darfo Albania” sh.p.k. Për të krijuar më tepër hapësirë dhe mundësi për gjetjen e burimeve të furnizimit me energji elektrike këto kompani aplikuan dhe morën licencën e furnizuesit të kualifikuar dhe importuesit të energjisë elektrike. Në këtë mënyrë efekti pozitiv i këtyre licencimeve është i dyanshëm:

- a) **e para**, ju dha mundësia dy konsumatorëve të mëdhenj dhe të rëndësishëm të gjejnë vetë burimet e furnizimit me energji elektrike, **dhe**
- b) **e dyta**, lehtësoi në një masë të konsiderueshme kërkesën për energji, e cila duhej të plotësohej nga prodhimi vendas i kompanisë publike KESH sh.a., duke i krijuar mundësinë asaj për plotësimin më mirë të kërkesës së konsumatorëve familjarë.

ERE licencoi dhe një kompani tjetër të vogël private, “Favina” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike me HC nën 5 MW. Me licencimin e kësaj kompanie numri i të licencuarve për prodhimin e energjisë elektrike arriti në 14 kompani, pa përfshirë këtu KESH sh.a.

Gjithashtu u shqyrtua aplikimi i kompanisë “Hidroinvest 1” sh.p.k. për ndërtimin e dy HC nën 5 MW në rrethin e Librazhdit. Megjithëse fuqia e instaluar e këtyre HC-ve është e vogël, i rëndësishëm është fakti, se ka filluar interesimi i biznesit për të investuar në sektorin privat të prodhimit të energjisë elektrike.

Monitorimi nga ana e ERE-s i veprimtarive të licencuara, ka qenë një tjetër drejtim i rëndësishëm i punës së saj. Monitorimi është realizuar në dy sektorët:

- a) në sektorin privat,
- b) në sektorin publik.

Sektorin privat përfshin kryesisht hidrocentralet e vogla të cilat Qeveria i ka dhënë me koncension dhe Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) deri tani përfaqësuar nga MIE dhe ME, ka nënshkruar marrëveshje koncension me shoqëritë private koncensionmarrëse. Gjithashtu ERE kur i ka licencuar ato, si dhe kur ka miratuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike që ato prodhojnë, ka përcaktuar disa detyrime ligjore dhe disa tregues e standarde, që këto shoqëri duhet t'i realizojnë. Gjatë vitit 2005 u realizua monitorimi i 5 shoqërive të tilla:

- i. “Wonder Power” sh.a. (HEC Bogovë),
- ii. “Essegei-Shqipëria-Smokthina” sh.p.k. (HEC Smokthinë),
- iii. “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k. (25 HEC-e të vegjël),
- iv. “Spahiu - Gjanç” shpk (HEC Gjanç) dhe
- v. “Favina” sh.p.k. (HC Vithkuq)

Rezultatet e para janë pozitive, por investimet e kryera për rehabilitimin e plotë të këtyre HEC-ve, për të arritur kapacitetet e projektuara janë të pamjaftueshme.

Sektorin publik, përfaqësohet nga KESH sh.a. që zotëron 99.5 % të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri (prodhim, shpërndarje, furnizim, eksport-import) dhe funksionon me tregues që miratohen nga Qeveria. Në vitin 2005, nisur nga shumë shqetësime të konsumatorëve familjarë për mënyrën e faturimit të energjisë elektrike, u monitorua zona e shpërndarjes elektrike Tiranë. Rezultati i këtij monitorimi nuk ishte aspak inkurajues. Megjithëse për zonën e shpërndarjes elektrike të Tiranës ishte raportuar 14 921 konsumatorë gjithsej pa matës më 31.12.2004, në muajin maj 2005, ERE konstaton se ky numur ishte 30 888. Ndërsa faturimi i energjisë elektrike aforfe për 4 756 konsumatorë familjarë ishte më i madh nga sa ishte përcaktuar në vendimet e ERE-s nga 200 deri në 600 kWh në muaj. ERE mori vendim që KESH sipas ligjit të gjobitej në masën maksimale me një shumë prej 300 000 lekë, si dhe të bënte kompensimin e plotë për të gjithë konsumatorët për sasinë e energjisë elektrike të faturuar më tepër. Gjithashtu, përveç publikimit të vendimit të saj në Fletoren Zyrtare, ERE njoftoi edhe dy ministrat që mbulonin KESH sh.a. në lidhje me situatën kritike që paraqitej në lidhje me sistemin e matjes në tërësi në shkallë vendi, dëmtimin e interesave të konsumatorëve dhe precedentin e krijuar nga moszbatimi i ligjit për sektorin e energjisë elektrike.

#### **II.4 Veprimtaria e ERE-s për forcimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në rajon e më gjërë në shërbim të integritetit të Shqipërisë në tregun rajonal**

ERE gjatë vitit 2005, ka vlerësuar si mjaft të rëndësishëm zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me strukturat homologe të vendeve të rajonit, me organizmat ndërkombëtarë në fushën e energjisë ku ajo aderon, si dhe me organizma të tjerë ndërkombëtarë që kontribuojnë në forcimin dhe zhvillimin e strukturave rregullatore.

Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike ka punuar në mënyrë sistematike për të ushtruar autoritetin e tij rregullues në sektorin e energjisë elektrike në Shqipëri në frymën e një tregu rajonal, i cili ka si objektiv përfshirjen e të gjitha vendeve të rajonit. Për këtë ERE në të gjitha hapat e ndërmarra ka ndjekur me rigorozitet direktivat e BE-se dhe më konkretisht Direktivën nr. 2003/54/KE të Parlamentit dhe Këshillit Europian e 26 qershorit 2003 në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë si dhe memorandumet e Athinës (2002 & 2003) të nënshkruara nga ministrat e energjisë të vendeve të rajonit, përfshi edhe vendin tonë. ERE ka ndjekur dhe ka marrë pjesë edhe në zhvillimet e tjera që kanë ndodhur në rajon për energjinë. Një nga këto zhvillime shumë të rëndësishme gjatë vitit 2005 ka qenë nënshkrimi më 25 tetor i Traktatit për Komunitetin e Energjisë në Europën Juglindore mes Bashkimit Europian dhe 9 vendeve të Europës Juglindore, përfshi edhe vendin tonë.

Ky Traktat është cilësuar si një arritje e madhe për paqen dhe stabilitetin në Europë. Traktati i Komunitetit të Energjisë do të rrisë sigurinë e furnizimit dhe do të mbështesë një sektor strategjik jetësor.

Kjo do të thotë se akses i komunitetit (*acquis communautaire*) për energjinë, mjedisin dhe konkurrencën do të vihet në zbatim aty. Hapja e tregut, garancitë për investime dhe një kontroll i fortë i rregullatorit në sektorët e energjisë do të rritet. ERE gjithashtu është pjesë e strukturave të këtij Traktati. ERE ka përfaqësuesit e saj në Bordin e Rregullatorëve, si dhe në Task Forcat e krijuara prej tij për çështjet kryesore të rregullimit.

Eksperienca dhe kualifikimi i personelit teknik dhe Bordit të Komisionerëve, bazuar në eksperiencën amerikane për problemet e rregullimit dhe të vendeve të zhvilluara të rajonit ka qenë gjithashtu një tjetër drejtim i rëndësishëm i punës së ERE-s gjatë vitit 2005. Për këtë ERE ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh, konferencash e seminaresh të zhvilluara midis vendeve të rajonit por edhe më gjerë në Europë dhe Amerikë. ERE aderon që prej vitit 1999 dhe është nga anëtarët themelues të Shoqatës së Enteve Rregullatore të Vendeve të Europës Juglindore dhe EuroAzisë (ERRA) të përbërë prej 21 rregullatorëve nga vende të ndryshme. Aktiviteti i kësaj shoqate financohet kryesisht nga USAID me drejtimin e NARUC që është Shoqata Kombëtare e Enteve Rregullatore të Sh.B.A-së. Përveç dy Komiteteve të përhershme të ERRA-s, atij të Licencimit e Monitorimit dhe Tarifave e Çmimeve, gjatë vitit 2005 është ngritur dhe Grupi i Punës së Juristëve, ku ERE ka përfaqësuesin e saj. Në të diskutohen dhe trajtohen çështje që shqetësojnë rregullatorët në veprimtarinë e tyre. Gjithashtu janë kryer trajnime të veçanta për monitorimin e tregjeve të energjisë, informimin dhe marrëdhëniet me publikun, si dhe për stafin e ri të rregullatorëve. Gjatë vitit 2005 janë kryer respektivisht dy vizita të ndërsjella mes ERE-s dhe Entit Rregullator të shtetit të Indianës në kuadrin e partneritetit mes këtyre dy rregullatorëve, si dhe është realizuar programi i intershipit, mbi çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve.

Duhet theksuar se kjo është një mënyrë shumë efektive për të shkëmbyer përvojë, për të prekuar nga afër dhe zgjidhur problemet aktuale rregulluese të natyrave të ndryshme. ERE ka përfutur shumë nga ky aktivitet në plotësimin dhe ndërmarrjen e shumë hapave bazuar në eksperiencën amerikane për çështjet e rregullatorit, aktivitet ky i filluar që prej vitit 2002 në bazë të një memorandumit mirëkuptimi mes këtyre dy Rregullatorëve.

ERE gjatë vitit 2005 ka zhvilluar takime pune dhe shkëmbimi të ndërsjellë me Entin Rregullator italian, atë bullgar dhe Zyrën për Energji të Kosovës, ku janë diskutuar çështje të përbashkëta dhe është shkëmbyer eksperiencë për shumë çështje të ndeshura gjatë hartimit të dokumentacionit sekondar dhe problemeve të tregut. ERE është anëtare e rregullt e Forumeve të Athinës, dhe ka kontribuar me pjesëmarrjen e saj gjatë vitit 2005 në këto aktivitete të cilat janë tepër të rëndësishme, sepse ndihmojnë në njohjen me të drejtat dhe detyrimet e vendeve në tregun e përbashkët të vendeve të Bashkimit Europian. Kështu e mbështetur mjaft nga USAID, NARUC, ERRA etj., ERE do të vazhdojë pjesëmarrjen në organizmat ku ajo aderon, si dhe do të zhvillojë më tej marrëdhëniet me organizma të ndryshëm ndërkombëtarë për të zhvilluar aftësitë profesionale dhe institucionale, si dhe për të kontribuar në mënyrë sa më efektive dhe bashkëkohore në reformën që ka përfshirë sektorin e energjisë elektrike në Shqipëri.

## **II.5 Veprimtaria financiare e ERE-s**

Veprimtaria financiare e ERE-s dhe problemet e administrimit, mbulohen dhe ndiqen me përgjegjësi të plotë nga një departament i caktuar konform legjislacionit financiar të shtetit shqiptar. Ky departament, në bashkëpunim me departamentet e tjera, përgatit projektbuxhetin për miratim, kontrollon dhe evidenton shpenzimet e kryera, fondet e përdorura për investime, dhe blerjet e vogla. Mbi bazën e buxhetit të miratuar për vitin aktual, llogariten dhe ndiqen pagesat e rregullimit nga të licencuarit dhe mbi bazën e analizave financiare bën kompensimin e detyrimeve, nëse është e domosdoshme.

Buxheti i ERE-s për vitin 2005 është krijuar në zbatim të nenit 12 të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe **nuk është pjesë e Buxhetit të Shtetit.**

Të ardhurat që nevojiten për të përballuar shpenzimet, sigurohen nga pagesat e rregullimit që ERE u ka caktuar të licencuarve, mbi bazën e të ardhurave që ata kanë planifikuar.

Për vitin 2005 të ardhurat e planifikuara nga pagesat e rregullimit kanë qenë 42,167,000 lekë dhe ato janë realizuar 32 367 000 lekë ose 77 %.

Pagesa e rregullimit që iu caktua KESH sh.a. për vitin 2005 nga 41 863 000 lekë, u realizua 31 396 000 lekë, ose 75 %. Kjo është e barabartë me 35 lekë në vit për një konsumator [31 396 000 lekë: 892 631 konsumator].

Shpenzimet e planifikuara për t'u kryer nga ERE janë pjesë e përmbushjes së detyrimit të saj ligjor dhe përmbajnë nevojat më të domosdoshme që ka ERE për një vit, siç janë : Pagat e personelit dhe kontributet, pagesat për konsulencë dhe publikime për informimin e opinionit publik, pagesat për energji - ujë - telefoni - shërbime interneti - mirëmbajtje, amortizim i aktiveve të qëndrueshme etj. Shuma e shpenzimeve të planifikuara për vitin 2005 nga 64 525 000 lekë u realizua 39 970 000 lekë ose 62 %. Sistemi i llogarive është mbajtur në përputhje me legjislacionin shqiptar për kontabilitetin. Shpenzimet e kryera janë pasqyruar saktë. Buxheti i ERE-s (plani i të ardhurave dhe shpenzimeve) është miratuar në Bordin e Komisionerëve dhe për respektimin e tij Bordi është informuar në mënyrë periodike. Bilanci i ERE-s është audituar nga një ekspert kontabël i AUTORIZUAR dhe rezultati është miratuar në Bordin e Komisionerëve.

### **III. GJENDJA E SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË SHQIPËRI**

Aktualisht sektori elektroenergjetik shqiptar përfaqësohet nga :

- a) **Sektori publik** (shtetëror) që përbëhet nga OST sh.a dhe KESH sh.a. (me gjenerimin dhe shpërndarjen), dhe
- b) **Sektori privat** që përbëhet nga kompanitë e vogla që kanë marrë me koncension me vendim Qeverie disa hidrocentrale të vegjël dhe nga kompanitë e vogla që kanë blerë nga AKP disa hidrocentrale të vegjël.

#### **III.1 SEKTORI PRIVAT**

**Sektori elektroenergjetik privat ka filluar të krijohet këto 3 vitet e fundit. Janë gjithsej 13 kompani të vogla private që zhvillojnë veprimtarinë në këtë sektor. Ato kanë gjithsej 45 HEC-e të vegjël me kapacitet deri në 5 MW (vetëm një është me kapacitet 9.2 MW). Prodhimi i tyre gjatë vitit 2004 arriti në 38,3 milionë kWh. Investimet e realizuara janë në vlerën 249 milionë lekë. Numri i punonjësve të punësuar nga këto kompani deri tani ka arritur në 223 vetë.**

Në përgjithësi gjendja teknike e këtyre HEC-VE të lëna pas dore prej vitesh ka qenë mjaft e rënduar, kështu që edhe investimet kryesisht janë bërë për rregullimin e veprave të marrjes, zëvendësimin apo riparimin e pajisjeve elektromekanike, restaurimin e godinave të këtyre objekteve, por në disa raste edhe për rregullimin e rrugëve, pasi dihet që këto hidrocentrale janë në zona të thella. Për vitin 2005 investimet e realizuara janë në vlerën rreth 249 milionë lekë në total ose 62% të parashikimit, i cili ishte 401.2 milionë lekë. Prodhimi i realizuar arrin në 38.35 milion kWh dhe ka një rënie kundrejt një viti më parë. Rënia vjen për disa arsye:

- Disa prej tyre ndërprejnë punën, sepse ishin në proces rehabilitimi;
- Karakteri tepër sezonal në përdorimin e ujit (uji përdoret për vaditje dhe për furnizimin e popullatës);
- Viti 2005 ishte një vit hidrik jo i mirë;
- Për mungesën e një ligji, KESH sh.a. nuk ua ka blerë energjinë elektrike, hidrocentraleve të privatizuara jo nëpërmjet koncensionit

ERE mendon se është e rëndësishme të trajtohet problemi i mosblerjes nga KESH sh.a. i energjisë së prodhuar nga hidrocentralet e shoqërive private, të cilat i kanë blerë nëpërmjet ankandit të organizuar nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit (AKP). Për rreth më shumë se një vit, ERE ka kërkuar tek institucionet që ligjërisht kanë detyrimin për ta rregulluar këtë problem, por akoma edhe sot nuk është zgjidhur. Edhe në raportin e paraqitur në Kuvend një vit më parë, ERE e ka bërë prezent, në këtë mënyrë: “**Është e nevojshme që OSHA të iniciojë sa më parë, marrjen e një vendimi nga Qeveria, për blerjen nga KESH sh.a. të energjisë elektrike të gjeneruesve privatë, me qëllim që ata të kenë garanci për investimet që do të bëjnë në të ardhmen. Zhvillimi i investimeve në këto burime gjeneruese është me rëndësi për faktin se ato duke qenë në pozicione fundore luajnë një rol shumë të mirë rregullues**”.

E keqja është se kjo kategori e prodhuesve të vegjël privatë në raport me prodhuesit e tjerë privatë që funksionojnë sipas ligjit për koncensionet, janë të diskriminuar.

Ky fakt, derisa të zgjidhet, është një faktor pengues për futjen e investimeve private në sektorin elektroenergetik (vendase dhe të huaja), sepse është një parakusht që kërkojnë investitorët privatë: nga kush do të blihet energjia e prodhuesve privatë, përderisa edhe për disa kohë vendi ynë nuk ka treg të hapur të energjisë elektrike?

Gjithashtu, një problem tjetër që kërkon zgjidhje ligjore për investitorët privatë, është çeshtja e pronësisë, kur sipërfaqet që do të zihen nga këto vepra hidrike janë në pronësi të shtetit dhe nuk ka akte ligjore se si do të bëhet kalimi i pronësisë, si do të paguhet etj., përveçse disa akte nënligjore apo urdhra administrativ që e bllokojnë këtë proces për efekt të kthimit dhe kompensimit të pronave për ish-pronarët.

Për të patur një ide më të plotë për veprimtarinë e këtyre HEC-ve, po paraqesim në mënyrë më analitike realizimin e treguesve kryesorë të HEC-ve të vegjël sipas tabelave në vijim:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Viti 2004	Viti 2005	Real. në %
1.	Prodhimi	000/ kWh	41,300	38,358	93
2.	Investimet	000/ lekë	307,000	249,009	81

Nr.	Emri i Kompanisë	Prodhimi (000 kWh)	Investimet e realizuara (000 lekë)
	<b>ME KONCESION</b>		
1.	AMAL	1021	1480
2.	EMIKEL	3065	21850
3.	SPAHIU-GJANÇ	3037	70922
4.	WONDER POWER	4734	8942
5.	HCA	12623	82364
6.	ESSEGEI SHQIPËRIA SMOKTHINA	12815	57721
	<b>SHUMA</b>	<b>37295</b>	<b>243279</b>

Nr.	Emri i kompanisë	Prodhimi (000 kWh)	Investimet e realizuara (000 leke)
	<b>BLERE NGA AKP</b>		
1.	MARJAKAJ	125	0
2.	KORSEL	548	2270
3.	WTS ENERGJI	109	0
4.	SARMIER	0	0
5.	SAROLLI	192	2670
6.	JUANA	88	0
7.	DARDANIA	0	790
	<b>SHUMA</b>	<b>1062</b>	<b>5730</b>

Në sektorin privat të energjisë elektrike, krahas prodhuesve të vegjël që trajtuam më lart, po hidhen hapat e parë drejt krijimit dhe hapjes së tregut të energjisë elektrike në vend. U licencua për herë të parë OST sh.a., e cila po shkon gradualisht drejt shkëputjes nga KESH sh.a. duke qenë në vartësi të plotë të Qeverisë. Funkcionimi i saj i pavarur nga KESH sh.a. dhe konsolidimi i saj është një kusht i rëndësishëm për shërbimin ndaj të licencuarve privatë në standarde sa më optimale. Është licencuar kompania “Darfo Albania” sh.p.k., e cila ka marrë nga ERE statusin e klientit të kualifikuar. Gjithmonë me objektivin e nxitjes së procesit të krijimit dhe hapjes së tregut u licencua kompania “GSA” sh.p.k. si furnizues i kualifikuar dhe importues i energjisë elektrike. Në mars 2005 iu dha Statusi i Klientit të Kualifikuar kompanisë “Kurum International” sh.p.k.. Në këtë mënyrë numri i klientëve të kualifikuar arriti në dy. Këto dy konsumatorë të mëdhenj industrialë kanë një konsum vjetor respektivisht: “Darfo Albania” sh.p.k. 114.95 GWh dhe “Kurum International” sh.p.k. 103 GWh.

Me qëllim krijimin e hapësirave të nevojshme për gjetjen e burimeve të furnizimit jashtë sistemit elektroenergjetik shqiptar, ashtu siç kërkohet dhe nga Modeli Transitor i Tregut, pas aplikimit këtyre kompanive iu dha licenca e furnizuesit të kualifikuar dhe importuesit të energjisë elektrike. Ky ishte një hap tjetër përpara në konsolidimin e tregut të energjisë elektrike në vend si në rritjen e numrit të aktorëve në treg, ashtu dhe në krijimin e konkurrencës në treg.

### III.2 SEKTORI PUBLIK (SHTETËROR).

Sektori publik (shtetëror) përfaqësohet **KESH sh.a.** shoqëri strategjike pronë e shtetit shqiptar, prej së cilës gjatë vitit 2004 filloi shkëputja e Operatorit të Sistemit të Transmetimit **OST sh.a.** KESH sh.a ruan pozitën monopol në tregun e energjisë elektrike në vend, për prodhimin, importin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Ajo zotëron 99 deri 99.5 % të sasisë së energjisë elektrike që hidhet në treg dhe deri tani importon e vetme 100 % të energjisë elektrike që duhet për të plotësuar mungesën e kapacitetit të prodhimit vendas.

Edhe **për vitin 2005 situata hidroenergjetike vlersohet e kënaqshme.** Prodhimi i energjisë elektrike nga 4,050 GWh i planifikuar, u realizua 5,409 GWh ose rreth 34 % më shumë. Ndërsa importi i planifikuar nga 2,250 GWh u realizua 365 GWh ose 16 %. Sasia e energjisë së planifikuar për t’u hedhur në rrjet për furnizimin e konsumatorëve nga 6,300 GWh u plotësua 5,780 GWh ose 91,7 %, me një diferencë prej 520 GWh. Kjo diferencë llogaritet afërsisht me sasinë mujore të planifikuar për furnizimin e konsumatorve (520:525). Mungesa e importit ka ardhur si rezultat i mospërgatitjes nga ana e KESH sh.a. për realizimin e kësaj detyre.

**Humbjet e energjisë elektrike për vitin 2005 paraqiten kritike. Targetat janë të parealizuara, dhe krahasuar me vitin 2004 ato janë janë 154 GWh më të mëdha (2,348-2194).** Nëse humbjet do të ndaheshin, ku ato janë krijuar, ne kemi këtë situatë:

	Në sasi [GWh]	Në %
a) Humbjet në transmetim	264	4,56
b) Humbjet në shpërndarje	2,084	37,1
• Teknike	1,095	19,5
• Joteknike	989	17,6

#### Bilanci i humbjeve gjithsej në vite ka këtë pamje:

	<u>2002</u>	<u>2003</u>	<u>2004</u>	<u>2005</u>	
				Plan	Fakt
1) Humbjet në sasi [GWh]	2.230	2.165	2.191	2,122	2,348
2) Humbjet në [%]	41,7	39,2	36,6	33,68	39,93

Humbjet e energjisë elektrike, përbëjnë një kosto financiare shumë të lartë si për vetë KESH-in, por edhe për konsumatorët e energjisë elektrike.

Një tregues mjaft i rëndësishëm për të vlerësuar situatën e KESH sh.a. është niveli i arkëtimeve të energjisë elektrike. Viti 2005 nuk ishte një vit i mirë për sa i përket këtij treguesi.

Pas tremujorit të parë, situata u përkeqësua. Në përgjithësi ky problem nuk u administrua me përgjegjësi dhe kërkesa për arkëtimet ra në mënyrë të ndjeshme.

**Situata e arkëtimeve në vite ka këtë pamje:**

	<u>2002</u>	<u>2003</u>	<u>2004</u>	<u>2005</u>	
				Plan	Fakt
1) Arkët. gjithsej në vlerë [mln/lekë]	17,496	22,176	27,132	31,602	25,102
2) Arkët. në [%] me pagesat e Qeverisë	88,3	92,5	94,9	97,06	85,59
3) Arkët. në [%] pa pagesat e Qeverisë	80,4	84,2	88,0	89,96	81,37
- Arkëtimet nga familjarët në 000/l	(14,132	-10,404	=-3,728)	14,132	10,404
- Arkëtimet nga familjarët në %		73,1	75,6	82	73,86

**Pra siç shihet, niveli i ulët i arkëtimeve është një problem mjaft i madh dhe në mënyrë të veçantë niveli mesatar i ulët i arkëtimeve të konsumatorët familjarë bëhet një problem akoma më shqetësues për kompaninë.** Mospagesa e energjisë elektrike është kthyer në një fenomen tipik sidomos në disa zona të vendit. Mosrealizimi i arkëtimeve për vitin 2005 rreth 6,5 miliard lekë (ose rreth 65 milionë dollarë US) më pak se plani i miratuar dhe 2 miliardë lekë më pak se sasia e arkëtuar një vit më parë, pakëson të ardhurat e kompanisë dhe burimin e financimit të investimeve. Mospagesa e energjisë elektrike pengon jo vetëm zhvillimin e reformës tarifore, por ajo përkeqson drejtpërdrejt cilësinë e shërbimit për paguesit korrekt të energjisë elektrike, prandaj dhe kërkohet një strategji e veçantë e organeve përgjegjëse për përmirësimin e këtij treguesi.

**Realizimi i pritshëm i investimeve në KESH sh.a. gjatë vitit 2005, gjithashtu nuk është pozitiv.** Nga 17 miliardë lekë investime të planifikuara, realizimi i pritshëm (KESH sh.a. kërkon rreth 2 muaj kohë pas mbylljes së vitit kalendarik për ta raportuar të saktë këtë tregues) është rreth 62,5 % ose me një deficit të përafërt – 6,4 miliardë lekë. Megjithëse ligji për sektorin e energjisë elektrike përcaktonte si datë përfundimtare 31 dhjetor 2004 plotësimin e konsumatorëve me matës të energjisë elektrike, KESH sh.a. ka hyrë në vitin 2006 me rreth 145 000 konsumatorë pa matës, ose 16 % e konsumatorve gjithsej në shkallë vendi ( rreth 904 000 konsumatorë gjithsej). Në lidhje me matjen, duhet theksuar se nga ana e KESH sh.a. vazhdimisht ka pasur një situatë konfuzë në raportim, çka tregon se këtë problem nuk e ka administruar në mënyrë korrekte dhe të përgjegjshme. **Mungesa e matjes përbën një problem shumë serioz edhe për faktin tjetër, sepse sipas nenit 52 të ligjit për sektorin e energjisë elektrike, faturimi pa matje ka pasur si afat të fundit të periudhës transitore datën 31 dhjetor 2004.** ERE e ka trajtuar domosdoshmërinë e ndërhyrjes për zgjidhjen ligjore të këtij problemi nga institucionet që e kanë për detyrë, për faktin se nëse deri në fund të vitit 2004 KESH sh.a. faturimet aforfe i bënte sipas miratimit nga ERE, gjatë vitit 2005 dhe në vazhdim faturimi aforfe bëhet pa miratim nga ERE dhe në këtë rast mbrojtja e konsumatorëve familjarë është e pagarrantuar.

Një problem tjetër mjaft i rëndësishëm që shoqëria KESH sh.a. e ka të programuar nga Qeveria, janë **kufizimet e energjisë elektrike.** Në shkallë vendi , por në mënyrë të veçantë në zonat rurale, kufizimet janë akoma në nivele kritike. Raportimet e kufizimeve në vite paraqiten, si vijon:

	<u>2002</u>	<u>2003</u>	<u>2004</u>	<u>2005</u>	
				Plan	Fakt
Kufizimet (GWh)	851	677	550	340	664

Kufizimet e energjisë elektrike në Shqipëri janë rezultat i mungesës së kapaciteteve gjeneruese dhe kapaciteteve të limituara transmetuese të rrjetit, të cilat krijojnë dhe humbje shumë të mëdha të energjisë elektrike.

Vëmendja e kompanisë, në kushtet kur realisht nuk ka një treg të hapur (të liberalizuar), duhet përqendruar në ndërtimin e një strategjie sa më efektive për uljen e humbjeve, dhe rritjen e arkitimeve, duke perfeksionuar metodat e administrimit dhe të menaxhimit për të rritur efikasitetin e tyre.

Gjatë gjithë vitit 2005 ERE i ka kushtuar një vëmendje shumë të madhe forcimit të rolit të saj, kapacitetit rregullues në përputhje të plotë me atë çfarë ka parashikuar ligji, si dhe ka ndjekur me shumë kujdes plotësimin e të gjitha detyrave që përcaktonte rezoluta e Kuvendit (Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin) e datës 2 mars 2005.

Gjithashtu bashkëpunimi i ngushtë me partnerët brenda dhe jashtë vendit, do të jetë një nga instrumentet kryesore për të çuar punën e ERE-s përpara sipas standardeve që kërkohen.

Edhe gjatë këtij viti, roli i rregullatorit do të jetë më i ndjeshëm dhe më aktiv në lidhje me marrëdhëniet dhe informimin e publikut, në monitorimin e kryerjes së shërbimeve ndaj konsumatorëve nga ana e të licencuarve, në zhvillimin e seancave për zgjidhjen e çështjeve që adresohen nga konsumatorët apo të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, si dhe në respektimin dhe marrjen në konsideratë të politikave të Qeverisë për sektorin e energjisë elektrike, siç përcaktohet nga ligji. ERE do të jetë vazhdimisht transparente në vendimet që merr dhe konsekuente në zbatimin korrekt e në mënyrë të drejtë të ligjit.

**ENTI RREGULLATOR I ENERJISË ELEKTRIKE**  
**Tiranë, më 25.1.2005**

**VENDIM**  
**Nr. 5, datë 16.2.2006**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1, DATË 11.1.2006 PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS NGA SHOQËRIA “KORSEL” SHPK TE SHOQËRIA “MAKSI ELEKTRIK” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.1, datë 11.01.2006 “Për transferimin e licencës nga shoqëria “Korsel” sh.p.k. te shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k., Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.02.2006, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Departamenti i Licencave dhe Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, mbi transferimin e licencës nga shoqëria “Korsel” sh.p.k. te shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k. për hidrocentralet Leskovik 1 dhe 2 të Rrethit të Korçës,

**VENDOSI:**

1. Në pikën 1 të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.1, datë 11.01.2006 “Për transferimin e licencës nga shoqëria “Korsel” sh.p.k. te shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k.” në fund të fjalisë të shtohet shprehja:

- me një afat 28-vjeçar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**VENDIM**  
**Nr. 6, datë 16.2.2006**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT DREJTUES TË ERE-S NR 14 , DATË  
11.7.2003 “LIDHUR ME KËRKESËN E BËRË NGA EMIKEL SHPK PËR MARRJE  
LICENCE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 11 të ligjit nr. 7973, datë 26.07.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, si dhe të nenit 4 të Marrëveshjes koncesionare që shoqëria “Emikel” sh.p.k. ka lidhur me Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.02 .2006, në kuptim edhe të sa ka vendosur dhe Këshilli Drejtues i ERE-s në mbledhjet e tij të datave 30.06.2003 dhe 11.07.2003

**VENDOSI:**

1. Në vendimin e Këshillit Drejtues të ERE-s nr.14, datë 11.07.2003 “Lidhur me kërkesën e bërë nga “Emikel” sh.p.k. për marrje licence për prodhimin e energjisë elektrike”, pika 1 ndryshohet si më poshtë :

- Të miratojë dhënien e licencës Emikel 2003 sh.p.k. për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike në hidrocentralet vendore Lenie, Çorovodë dhe Tuçep.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**VENDIM**  
**Nr. 7, datë 16.2.2006**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26, pikat 1, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.26, datë 13.05.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.05.2005, neni 11 germa A, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.02.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k. , për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqërinë “Favina 1” sh.p.k .

2. Ngarkohet Departamenti i Çmimeve dhe i Tarifave, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**VENDIM**  
**Nr. 8, datë 16.2.2006**

**PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE NËPËRMJET SHITJES PËR HIDROCENTRALET E SHOQËRISË “SARMIER” SHPK**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.02.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Sarmier” sh.p.k., për miratimin e transferimit të aseteve nëpërmjet shitjes të H/C-ve, Rehovë-Kolonjë, Çarshovë-Përmet dhe Treska 1-Korçë, nga shoqëria “Sarmier” sh.p.k. te shoqëria “Projeksion” sh.p.k.,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e transferimit të aseteve nëpërmjet shitjes të H/C-ve Rehovë-Kolonjë, Çarshovë-Përmet dhe Treska 1-Korçë, nga shoqëria “Sarmier” sh.p.k. te shoqëria “Projeksion” sh.p.k.

2. Kushtëzohet ky miratim i transferimit të aseteve, me likuidimin nga shoqëria “Sarmier” sh.p.k. të të gjitha detyrimeve që ka me ERE-n gjatë veprimtarisë së saj, në fushën e prodhimit të energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**VENDIM**  
**Nr. 9, datë 17.2.2006**

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA SHOQËRIA “WONDER POWER” SHA PËR PERIU DHËN 1.1.2006 – 31.12.2006**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël” dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.54, datë 26.09.2005 “Për afatin e shqyrtimit të aplikimeve të të licencuarve për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet e vegjël, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.02.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Wonder Power” sh.a., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-in Bogovë,

**VENDOSI:**

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria “Wonder Power” sh.a., për HEC-in Bogovë, për periudhën 1.01.2006 – 31.12.2006, të jetë 5.85 lekë/kWh.

2. Ngarkohet shoqëria “Wonder Power” sh.a. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**VENDIM**  
**Nr. 11, datë 23.2.2006**

**PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR AKTIVITETIN E PRODHIMIT, SHPËRNDARJES,  
FURNIZIMIT, IMPORTIT DHE EKSPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË  
KESH SHA**

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1, germat a, c, ç, d, dh, 15 pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27 datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, nenet 4 pika 1 germat b, d, e, f, g, dhe 5 pika 1, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.53, datë 23.11.2004, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.02.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga KESH sh.a. për marrje licence për aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit, importit dhe eksportit të energjisë elektrike, konstatoi se nga tërësia e kërkesave të parashikuara në aktet e mësipërme, KESH sh.a. ka plotësuar kryesisht kërkesat, por nuk ka plotësuar kushtet si më poshtë:

I. Në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 33 pika 1,

1. Ndarjen e plotë të llogarive financiare, ndërmjet prodhimit, transmetimit, shpërndarjes.

II. Në zbatim të rregullores për procedurat e licencimit neni 10 germa C, pika 3 dhe neni 11 pika 1, paragrafi 8 dhe pika 3, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.53, datë 23.11.2004, pika II:

1. Sigurimi i aktiviteteve të licencuara.

2. Përcaktimi i faktorëve të humbjeve të energjisë në rrjetin shpërndarës për çdo nivel tensioni.

3. Vlerësimin paraprak të ndikimit në mjedis të aseteve prodhuese, në nivel lokal dhe kombëtar.

4. Raportin e ekspertit kontabël.

5. Transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit nga KESH sh.a. për OST sh.a. në sasi dhe në vlerë, si dhe ndarjen e plotë me OST sh.a.

6. Pasqyrimin në statutin e shoqërisë KESH sh.a. të ndryshimeve në kapitalin themeltar në përputhje me urdhrin e Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.03.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit”.

7. Planin e investimeve për zgjerimin e rrjetit shpërndarës për vitin 2006, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11, pika 3.

Për sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

I. Dhënie e licencave shoqërisë KESH sh.a. për aktivitetet e:

1. prodhimit të energjisë elektrike me një afat kohor prej 3 vjetësh ;

2. shpërndarjen e energjisë elektrike me një afat kohor prej 3 vjetësh;

3. furnizimin e energjisë elektrike me një afat kohor prej 3 vjetësh;

4. eksportimin e energjisë elektrike me një afat kohor prej 1 viti;

5. importimin e energjisë elektrike me një afat kohor prej 1 viti.

II. Kjo licencë jepet me kusht. Shoqëria KESH sh.a., brenda datës 31.12.2006, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

1. Ndarjen e plotë të llogarive financiare në përputhje me ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 33, pika 1.

2. Raportin e ekspertit kontabël në zbatim të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” me të gjitha ndryshimet përkatëse neni 251, 256 dhe urdhrin të Ministrit të Ekonomisë nr.63 datë 18.03.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH”, Tiranë dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit”, pika 3.

3. Transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit nga KESH sh.a. për OST sh.a. në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë” pika 4, urdhrin të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.03.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH”, Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” pika 2.

4. Sigurimi i aktiviteteve të prodhimit, shpërndarjes, furnizimit, eksportit dhe importit të energjisë elektrike në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 10 germa C, pika 3.

5. Vlerësimin paraprak të ndikimit në mjedis në nivel lokal dhe kombëtar të aseteve prodhuese në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 1.

6. Përcaktimin e faktorëve të humbjeve të energjisë në rrjetin shpërndarës për çdo nivel tensioni, në përputhje me aneksin B të licencës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

7. Pasqyrimin në statutin e shoqërisë KESH sh.a., të ndryshimeve në kapitalin themeltar në përputhje me urdhrin e Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.03.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH”, Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit”.

8. Planin e investimeve për zgjerimin e rrjetit shpërndarës për vitin 2006, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 3.

III. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, ERE rezervon të drejtën për ta rishikuar këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S  
Pjetër Dema

**VENDIM**  
**Nr. 12, datë 23.2.2006**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.05.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” me ndryshimet përkatëse, neni 11; germa A; vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.28, datë 24.06.2005 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit”, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.29, datë 24.06.2005 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE – s, në mbledhjen e tij të datës 23.02.2006, pasi shqyrtoi aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria “KESH” sh.a. për vitin 2006,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria “KESH” sh.a. për vitin 2006.

2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve, Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Licencave dhe Monitorimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S  
Pjetër Dema

**VENDIM**  
**Nr. 13, datë 28.2.2006**

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA**  
**SHOQËRIA “SPAHIU-GJANÇ” SHPK PËR PERIUdhËN 1.01.2006 – 31.12.2006**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël” dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.54, datë 26.09.2005 “Për afatin e shqyrtimit të aplikimeve të të licencuarve për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet e vegjël, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.02.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Spahiu-Gjanç” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-in Gjanç,

**VENDOSI:**

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria “Spahiu-Gjanç” sh.p.k. për HEC-in Gjanç, për periudhën 1.01.2006 – 31.12.2006, të jetë 6,28 lekë/kWh.
2. Ngarkohet shoqëria “Spahiu-Gjanç” sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

- duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose
  - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën:  
Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"
- Për informacione më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit:  
04 255 563 ose 04 267 468

**BOTIMET E TJERA TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE:**

- 1. REGJISTRAT E NOTERISË, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.**
- 2. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË dhe të gjitha kodet e legjislacionit shqiptar.**
- 3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI të përditësuara për:**

1. PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005) .....	600
3. SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të).....	1500
4. TAKSAT DHE TATIMET (suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT.....	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT.....	2000

**DOLI NGA SHTYPI:**

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR .....	1000

Doli nga shtypi më 6.3.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"  
Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë